



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-20

**PËR KËRKESAT TEKNIKE PËR PRODUKTE
DHE VLERËSIM TË KONFORMITETIT**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Rregullores Nr. 2001/9 të dt. 15 maj 2001 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Kreu 5.1(ç), 9.1.1 dhe 9.1.26 (a), me qëllim të përcaktimit të kërkesave teknike të produkteve dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit dhe në harmoni me standardet e Bashkësisë Evropiane,

Miraton:

**LIGJIN PËR KËRKESAT TEKNIKE PËR PRODUKTE
DHE VLERËSIM TË KONFORMITETIT**

KREU I

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1. Me këtë Ligj rregullohet mënyra e përcaktimit të kërkesave teknike për produkte dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara si dhe nxjerrja e rregullave teknike me të cilat Ministritë përkatëse për disa produkte apo tërësinë e një grupi të produkteve e rregullojnë për së paku një nga elementet vijuese:

- (i) Kërkesat teknike të cilat duhet të plotësojnë produktet që vendosen në treg dhe/ose në përdorim,
- (ii) Të drejtat dhe obligimet e personave fizikë dhe juridik të cilët i vendosin produktet në treg dhe/ose përdorim,
- (iii) Procedurat e vlerësimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara teknike,
- (iv) Të drejtat dhe obligimet të organeve për vlerësimin e konformitetit të produkteve me kërkesat teknike,
- (v) Dokumentet (vërtetimet, dokumentacionin teknik) të cilat duhet të jenë në dispozicion të organeve të autorizuar para vendosjes së produkteve në treg dhe/ose në përdorim,
- (vi) Mënyrën e shënjitimit të produkteve.

1.2. Me këtë Ligj rregullohet mbikëqyrja për plotësimin e kushteve të përcaktuara në rregullat teknike dhe vlefshmëria e dokumenteve për konformitetin dhe shenjat e konformitetit të lëshuara jashtë vendit.

1.3. Ky Ligj nuk zbatohet për përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit për produkte të cilat janë rregulluar me ligje të veçanta.

Neni 2

Produktet mund të vendosen në treg, apo të përdoren, vetëm nëse janë në pajtim me kërkesat teknike të përcaktuara, nëse konformiteti i tyre është verifikuar në bazë të procedurës së përcaktuar dhe nëse janë shënjuar në pajtim me rregullat teknike të përcaktuara.

Neni 3

Termet që përdoren në Ligj kanë kuptimet si në vijim:

(i) **Produkt** - është çdo material si rezultat i një aktiviteti ose procesi, përfshirë edhe pajisjet teknike, materialet e përpunuara dhe të tjera të destinuara për treg.

(ii) **Prodhues** - është çdo person fizik ose juridik që është përgjegjës për projektimin, prodhimin e produktit apo bënë përfaqësimin e tij për interes të vetin ose kur e ndryshon apo përpunon me themel produktin me qëllim të vendosjes së tij në treg dhe/ose në përdorim.

(iii) **Vendosja në treg** - është veprim fillestar kur produkti mund të blihet lirisht nga kushdo, pas të cilit ai kalon nga faza e prodhimit ose e importit në fazën e distribuimit në treg dhe/ose përdorim. Ky definicion nuk ka të bëjë për produkte që prodhohen ose importohen me qëllim të shitjes në tregun e huaj.

(iv) **Vënia në përdorim e produktit** - është momenti kur produkti hyn në fazën e parë të përdorimit prej shfrytëzuesit të fundit.

(v) **Mbikëqyrja e tregut** - nënkupton metodat, procedurat dhe veprimet e organeve kompetente, për tu siguruar që produktet në treg plotësojnë kërkesat përkatëse, dhe të jenë të shënuar me shenjen e konformitetit dhe të pajisura me dokumentacionin teknik të nevojshëm.

(vi) **Standard Evropian i harmonizuar** - është një standard Evropian i adaptuar prej organizatës Evropiane për standarde i nxjerrur nën mandatin e Komisionit Evropian dhe i mbështetur në Direktivat e publikuara në “Gazetën Zyrtare” të Komunitetit Evropian.

(vii) **Akreditimi** - nënkupton veprimtarin sipas së cilës një organ kompetent zyrtar njeh zyrtarisht kompetencat e një trupi ose personi që kryen një veprimtari specifike.

(viii) **Vlerësimi i konformitetit** - nënkupton mbikëqyrjen sistematike të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që ka të bëjë me përcaktimin se a janë plotësuar kërkesat teknike përkatëse për produkte.

(ix) **Shenja e konformitetit** - nënkuptohet shenja e vendosur në produkt me të cilën kuptojmë se konformiteti i produktit është vërtetuar sipas procedurave të përcaktuara me rregullat teknike.

(x) **Organi për vlerësimin e konformitetit** - nënkupton laborator të pavarur për furnizuesin, organ i certifikuar, organ mbikëqyrës ose organ tjetër që bashkëvepron në procedurën e vlerësimit të konformitetit.

(xi) **Rregulla teknike** - janë aktet nënligjore me karakter teknik të cilat i përcaktojnë karakteristikat e produkteve ku përfshihen edhe masat administrative që zbatohen për shkeljet e tyre.

KREU I II PËRCAKTIMI I KËRKESAVE TEKNIKE

Neni 4

Me kërkesa teknike përcaktohen detyrimet për personat juridikë dhe fizikë që vendosin produktet në treg dhe/ose në përdorim, që ato produkte mos të jenë të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut, të jenë të padëmshme për konsumatorin, mjedisin dhe pasurinë, dhe kushtet tjera të parashikuara me anë të kërkesave teknike zbatimi i të cilave është i detyruar dhe në vazhdimësi.

Neni 5

5.1. Ministrinë përkatëse, në pajtim me këtë Ligj, nxjerrin rregulla teknike me të cilat përcaktohen kërkesat teknike për produkte ose grupin e produkteve si dhe përcaktohen procedurat e vlerësimit të konformitetit me qëllim të:

- (i) Sigurisë së produkteve,
- (ii) Mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve, shtazëve dhe bimëve,
- (iii) Mbrojtjes së mjedisit,
- (iv) Mbrojtjes së konsumatorit dhe shfrytëzuesve tjerë,
- (v) Mbrojtjes së pasurisë ose
- (vi) Mbrojtjes së interesave tjera të përgjithshme.

5.2. Ministrinë përkatëse i nxjerrin Rregullat teknike nga paragrafi 1 i këtij neni në pajtim me Programin e zbatimit të cilin e nxjerrë Qeveria e Kosovës në propozim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

5.3. Rregullat teknike nga paragrafi 1. i këtij neni nxirren me qëllim të harmonizimit të legjisllacionit të Kosovës me atë të BE-së në fushën teknike.

5.4. Me rastin e nxjerrjes së rregullave teknike nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të merren parasysh parimet ndërkombëtare dhe obligimet e marra nga marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe me qëllim të eliminimit të pengesave teknike në tregti.

5.5. Konsiderohet që produkti është në harmoni me rregullat teknike nëse i përgjigjet kërkesave të standardeve të përcaktuara në Kosovë të cilat janë adaptuar në harmoni me standardet Evropiane.

5.6. Regjistrin e standardeve në Kosovë nga paragrafi 5. të këtij neni e publikon Agjencia e Standardizimit e Kosovës, në "Gazetën zyrtare".

5.7. Në rastin kur vërtetohet se produktet, janë konform me rregullat teknike nga paragrafi 1. i këtij neni, dhe janë prodhuar e mirëmbajtur në mënyrë të rregullt, si dhe përdoren për destinimin e paraparë, por ato mund të rrezikojnë shëndetin dhe/ose sigurinë e shfrytëzuesit ose personave tjerë, Ministria përkatëse nga paragrafi 1. i këtij neni merr

masa për tërheqjen e tyre nga tregu, ndalesën ose kufizimin e vendosjes së tyre në treg dhe/ose në përdorim.

5.8. Nëse vërtetohet që produktet plotësojnë kërkesat e një standardi të Kosovës nga paragrafi 5. të këtij neni por nuk i plotësojnë kërkesat e rregullave të caktuara teknike nga paragrafi 1. i këtij neni ose ai produkt i prodhuar sipas standardit mund të rrezikojë shëndetin dhe/ose sigurinë e shfrytëzuesit ose personave të tjerë. Ky standard duhet të fshihet nga Regjistri i standardeve të cekur në paragrafin 6. të këtij neni.

5.9. Ministritë përkatëse nga paragrafi 1 i këtij neni menjëherë duhet ta njoftojë publikun, mbi cilën do prej masave të parashikuara në paragrafin 7. dhe 8. të këtij neni, nëpërmjet mjeteve të informimit publik dhe në “Gazetës Zyrtare”.

KREU I III PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

Neni 6

Me Rregulla teknike përcaktohen kërkesat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit që duhet plotësuar produktet përpara se personat fizik apo juridik t'i vendosin në treg dhe/ose përdorim dhe të:

- (i) Sigurojë zbatimin e procedurave të vlerësimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara teknike,
- (ii) Nxjerrë, apo sigurojë deklaratën e konformitetit, vërtetimin ose ndonjë dokument tjetër për konformitetin (këtu e tutje: dokumentin për konformitetin),
- (iii) Komplettojë dhe ruaj dokumentacionin teknik në madhësinë, formën dhe afatet e përcaktuara,
- (iv) Bëjë shënjimin sipas dispozitave për shenjat e konformitetit.

Neni 7

7.1. Në produktet, që janë konform me kërkesat e rregullave teknike, sipas dispozitave duhet të vendoset shenja për konformitetin.

7.2. Formën, përmbajtjen dhe pamjen e shenjës për konformitetin dhe aktet nënligjore për zbatimin e saj përcaktohen nga Ministria për Tregti dhe Industri.

7.3. Produktet që nuk janë konform me kërkesat e Rregullave teknike dhe produktet për të cilat nuk kërkohet shënjimi me shenjat për konformitet, te këto produkte është e ndaluar të vendosen shenjat për konformitet ose shenjat tjera që janë të ngjashme me shenjat e konformitetit, të cilat mund krijojnë paqartësi në treg ose mashtrojnë konsumatorët.

Neni 8

8.1. Me rregulla teknike përcaktohet procedura e vlerësimit të konformitetit për çdo grup produktesh.

8.2. Për vlerësimin e konformitetit nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet njëra nga procedurat vijuese ose kombinimi i tyre:

- (i) Vlerësimi konformitetit nga prodhuesit e produktit,
- (ii) Vlerësimin e konformitetit të produktit të cilin e kryen organi për vlerësimin e konformitetit nga një mostër e marrë në treg ose nga procesi i prodhimit,
- (iii) Menaxhimi me sistemin për sigurimin e kualitetit gjatë procesit të prodhimit,
- (iv) Vërtetimi i konformitetit dhe zbatimi i mbikëqyrjes mbi sistemin e menaxhimit të sigurimit të kualitetit gjatë procesit të prodhimit, të cilin e zbaton organi për vlerësimin e konformitetit.

KREU IV ORGANET PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT DHE KËRKESAT TË CILAT DUHET TË PLOTËSOHEN

Neni 9

9.1. Me Rregulla teknike përcaktohen kërkesat e veçanta që duhet t'i plotësojë organi për vlerësimin e konformitetit dhe mbikëqyrja e punës së tyre.

9.2. Ministritë përkatëse që nxjerrin rregullat teknike nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktojnë kërkesat që duhet ti përmbushin organet që zbatojnë vlerësimin e konformitetit.

9.3. Me rregull teknike rregullohet procedura e mbikëqyrjes për punën e organit për vlerësimin e konformitetit si dhe masat që duhet ndërmarrë në rastin mosplotësimi të kërkesave nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 10

Kërkesat të cilat duhet të plotësojnë organet nga neni 9. paragrafi 1. i këtij Ligji kanë të bëjnë me:

- (i) Aftësinë profesionale të personelit të organit për vlerësim të konformitetit,
- (ii) Pajisjet e nevojshme,
- (iii) Sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërinë në procedurën e vlerësimit të konformitetit,
- (iv) Ruajtjen e sekretit të punës,
- (v) Përgjegjësinë për punën e kryer, përveç në rast kur përgjegjësia është përcaktuar me ligj tjetër,
- (vi) Kushtet tjera që duhet të plotësojnë organet për vlerësimin e konformitetit.

Neni 11

11.1. Kur me Rregulla teknike kërkesat e përcaktuara janë në pajtim me nenin 10. të këtij Ligji, organet për vlerësimin e konformitetit mund të kryejnë punë të përcaktuara me autorizim të dhënë nga Ministritë përkatëse që kanë nxjerrë rregullat teknike.

11.2. Autorizimi nga paragrafi 1. i këtij neni mund të kufizohet në kohë ose të vlejë deri në anulimin e tij.

11.3. Organet për vlerësimin e konformitetit, kërkesat nga neni 10. i këtij Ligji duhet tu përmbahet dhe ti zbatoj gjatë gjithë afatit të autorizimit.

11.4. Nëse vërtetohet se gjatë afatit të autorizimit organi për vlerësimin e konformitetit nuk përmbush kërkesat nga neni 10, Ministria përkatëse që ka nxjerr rregullën teknike merr vendim për anulimin e autorizimit.

11.5. Kundër vendimit nga paragrafi 1. dhe 4. të këtij neni nuk lejohet ankesë, por mund të ngritët kontest administrativ.

Neni 12

12.1. Organet për vlerësimin e konformitetit, të caktuara për zbatimin e detyrave sipas dispozitave të këtij Ligji, lëshojnë dokumentet për konformitetin në bazë të kërkesave të personave fizikë ose juridikë të cilët vendosin produktin në treg dhe/ose në përdorim.

12.2. Organet për vlerësimin e konformitetit dhe paraqitësi i kërkesës për vlerësim të konformitetit lidhin kontratë me shkrim në të cilën përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë reciproke lidhur me lëshimin e dokumenteve për konformitetin.

KREU V VLEFSHMËRIA E DOKUMENTEVE DHE SHENJAVE TË KONFORMITETIT TË LËSHUARA JASHTË KOSOVËS

Neni 13

13.1. Në Kosovë vlejnë dokumentet mbi konformitetin dhe shenjat e konformitetit të lëshuara jashtë nëse janë dhënë në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare që i ka lidhur Kosova.

13.2. Ministritë përkatëse të cilat kanë nxjerrë Rregullën teknike mund të njohin vlefshmërinë e dokumentit për konformitetin dhe shenjat e konformitetit të lëshuara jashtë vendit, nëse janë identike me Rregullat teknike për produkte, të cilat janë nxjerrë në Kosovë dhe nëse procedurat e organeve që kanë kryer vlerësimin e konformitetit janë me të njëjtat procedura dhe kërkesa të përcaktuara me rregullën teknike të Kosovës.

13.3. Evidentimin e dokumenteve të zbatueshme për konformitetin dhe shenjat e konformitetit si dhe organet për vlerësimin e konformitetit e bëjnë Ministritë përkatëse kompetente për nxjerrjen e rregullave teknike.

KREU VI MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

Neni 14

14.1. Plotësimin e kërkesave nga ky Ligj dhe dispozitave të nxjerra për zbatimin e tij e mbikëqyrë organi inspektues në pajtim me fushë veprimtarinë e vet.

14.2. Inspektorët e kompetent kanë autorizim për marrjen e masave që dalin nga dispozitat e veçanta që kanë të bëjnë me punën e tyre, sipas këtij Ligji dhe rregullave të veçanta nga neni 5. i këtij Ligji.

14.3. Përveç autorizimeve nga paragrafi 2. i këtij neni inspektorët kompetent mundën:

- (i) të kërkojnë nga furnizuesi të gjitha informatat dhe shqyrtimin e dokumenteve të lëshuara për konformitetin dhe dokumentacionin teknik,
- (ii) të bëjë shikimin, verifikimin dhe kontrollin e produkteve duke pasur parasysh konformitetin me rregullat kur produktet vendosen në treg, apo kur ato fillojnë të përdoren,
- (iii) të marrin mostrat e produktit dhe ti dërgojnë ato në kontrollim dhe vlerësim të konformitetit,
- (iv) të kërkoj mënjanimin e jokonformitetit të vërtetuar të produktit kur kjo është e mundur në të kundërtën do të urdhëroj tërheqjen e produktit nga tregu,
- (v) të kërkojë që produktet të pajisen me shenjat e përcaktuara apo të hiqen shenjat e palejuara të shënuara në produkt,
- (vi) të ndalojë vendosjen në treg, kufizoj vendosjen në treg, të urdhërojë tërheqjen e produkteve pa konformitet nga tregu dhe të merr masa shtesë që të sigurohen për respektimin e ndalesës,
- (vii) të lajmëroj Ministrinë përkatëse që ka nxjerr rregullën teknike, e cila ka të bëjë me produktin e caktuar, dhe të ndërmer veprime të përcaktuara me dispozitat për njoftim reciprok,
- (viii) të urdhërojë eliminimin e produkteve pa konformitet në qoftë se kjo është e domosdoshme për ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, në pajtim me nenin 5 (ii) të këtij Ligji.

14.4. Nëse organi inspektues i kompetent nuk disponon me njohuri të nevojshme profesionale apo pajisje të nevojshme për zbatimin e kontrollit testimit apo shqyrtimit nga paragrafi 3 i këtij neni, zbatimin e këtyre veprimeve të caktuara, në kuadër të mbikëqyrjes inspektuese, mund t'ua besojë institucioneve të aftësuara për këtë lloj veprimtarie.

14.5. Shpenzimet e procedurës inspektuese (shpenzimet e kontrollit dhe verifikimit të konformitetit të produkteve dhe shpenzimet tjera në lidhje me inspektimet), të bëra gjatë zbatimit të mbikëqyrjes, i bartë personi fizik ose juridik nëse vërtetohet që produkti nuk ka qenë në konformitet me kërkesat themelore.

Neni 15

Qeveria e Kosovës me akt nënligjor përcakton, mënyrën e njoftimit të shteteve tjera, apo subjektet ndërkombëtare, për masat e Ministrive përkatëse me të cilat ndalohet ose kufizohet vendosja e ndonjë produkti në treg dhe/ose përdorim, apo urdhëron tërheqjen e tij nga qarkullimi për shkak të interesit publik, dhe nëse ato masa ndikojnë në shkëmbimin e lirë të mallrave në tregtinë ndërkombëtare.

KREU VII DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 16

16.1. Me gjobë prej 1.000 deri 5.000 € do të gjobiten për kundërvajtje personi juridik, gjegjësisht me gjobë prej 250 deri 500 € personi fizik që në lidhje me kryerjen e pavarur të veprimtarisë:

- (i) Vendos në treg, apo fillon të përdorjë produktin në kundërshtim me nenin 2. të këtij Ligji,
- (ii) Vendos në treg, apo fillon të përdorjë produktin në kundërshtim me nenin 5. paragrafi 1. të këtij Ligji,
- (iii) Në kundërshtim me nenin 7. paragrafi 1. të këtij Ligji, në produktet që janë në pajtim me kërkesat e përcaktuara teknike, nuk vendosë shenjën e caktuar të konformitetit,
- (iv) Në kundërshtim me nenin 7. paragrafi 3. të këtij ligji i shënjon produktet me shenja të konformitetit ose shenja tjera që janë të ngjashme me shenjat e konfomitetit deri në atë masë që do të mund të shkaktojnë paqartësi në treg ose mashtrojnë konsumatorin,
- (v) në kundërshtim me nenin 9. të këtij Ligji kryen punë të organeve për vlerësimin e konformitetit në lidhje me vlerësim të konfomitetit,
- (vi) Në kundërshtim me nenin 14. paragrafin 2. dhe 3. të këtij Ligji nuk vepron në pajtim me vendimet përfundimtare të organeve inspektuese kompetente.

16.2. Me dënim gjobe prej 100 deri 300 € do të dënohen për kundërvajtje edhe personat përgjegjës të personit juridik për kundërvajtjen e bërë nga paragrafi 1. i këtij neni.

KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Qeveria e Kosovës nxjerr Programin e zbatimit nga neni 5. paragrafi 2. dhe aktin nënligjor nga neni 15. i këtij Ligji në afat prej 1 viti nga dita kur hyn në fuqi ky Ligj.

Neni 18

Procedurat ndëshkimore të filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të kryhen sipas dispozitave ndëshkimore që kanë qenë në fuqi deri ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Neni 19

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji pushojnë të gjitha dispozitat që kanë vlejte për fushën që rregullon ky ligj duke përfshirë nenet 7 deri në 14 të Ligjit për Standardizim nr. 2004/12.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-20
24 qershor 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci